

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 26.11.2024, në pajtim me nenin 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) dhe (2) dhe neni 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur për Iniciativën për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor nga avokati Aco Vasilev, nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

**Iniciativa për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të parashtruar nga avokati Aco Vasilev nga Shkupi, të evidentuar nën SU-03.nr.452/24 të datës 05.07.2024, NUK MIRATOHET.**

## A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat, avokati Aco Vasilev nga Shkupi, parashtrroi kërkesën në Gjykatën Supreme të RMV, të evidentuar nën SU-03.nr.452/24 të datës 05.07.2024, me propozim që Seanca e përgjithshme të miratojë qëndrim parimor ose mendim juridik parimor në lidhje me atë se a mundet që një gjyqtar i gjykatës themelore që vepron në procedurë jashtë kontestuese pa propozim të propozuesit të autorizuar ka autorizim që aktvendimin e tij paraprak, të shpallur si të plotfuqishëm dhe të zbatuar në Agjencinë për kadastër të patundshmërive ta shfuqizojë dhe të merr aktvendim të ri të modifikuar.

Parashtruesi i iniciativës thekson se në pajtim me Ligjin për mbylljen e procedurave të falimentimit të hapura në pajtim me Ligjin për barazimin e detyrueshëm të falimentimit dhe likuidimit dhe Ligjin për falimentim, me propozim të Drejtorit të falimentimit të Shoqërisë për prodhim të qumështit dhe prodhimeve të qumështit BANA DOOEL Shkup në falimentim, për përcaktimin e statusit juridik të objektit të paligjshëm në procedurën e falimentimit, në Gjykatën Themelore Civile Shkup me lëndën e formuar dhe është marrë aktvendim VPP-26/22 të datës 02.02.2022, me të cilin propozimi i propozuesit është miratuar dhe është përcaktuar status juridik i objektit të paligjshëm në falimentim.

Thekson se në pajtim me njoftimin e Agjencisë për kadastër të patundshmërisë numër 1315-7690/10 të datës 25.05.2022 gjykata ka marrë aktvendim VPP-26/24 të datës 11.04.2024, me të cilin propozimi i propozuesit refuzohet si i pabazë, ndërsa aktvendimin VPP-26/22 të datës 02.02.2022 e shfuqizon.

Në shtojcë të iniciativës nga parashtuesi nuk është dorëzuar praktikë e ndryshme gjyqësore, përkatësisht nuk janë dorëzuar vendime nga të cilat do të rezultonte nevoja për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor për çështje të rëndësishme për sigurimin unik me zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Nga shkaqet e sipër theksuara, nuk janë të plotësuara kushtet ligjore për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor.

**23.01.2025**

**Shkup**

**SEANCA E PËRGJITHSHME E GJYKATËS SUPREME  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**